

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

ZYRËS AUSTRIAKE TË PATENTAVE

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale e Republikës së Shqipërisë (DPPI) dhe Zyra Austriake e Patentave (ZAP), në vijim të referuara si “Zyrat” duke:

KONSIDERUAR rëndësinë e pronësisë intelektuale (në veçanti pronësinë industriale) për zhvillimin e ekonomisë, promovimin e inovacionit dhe shkëmbimin e teknologjisë,

NJOHUR nevojën për të promovuar dhe përmirësuar inovacionin dhe për të forcuar sistemet kombëtare të pronësisë industriale (PI) me qëllim garantimin e administrimit të duhur, mbrojtjen dhe përdorimin e të drejtave të pronësisë industriale,

KUPTUAR nevojën për bashkëpunim më të gjerë bilateral ndërmjet Zyrave për të forcuar sistemet e pronësisë industriale ekzistuese duke krijuar një mekanizëm për të patur shkëmbim të rregullt të informacionit dhe të praktikave më të mira dhe për të ndërmarrë së bashku trajnime dhe aktivitete të tjera bashkëpunuese, si dhe për të kontribuar në përhapjen e tij në rajon,

DËSHIRUAR nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet Zyrave, me qëllim promovimin e shkëmbimeve ekonomike dhe teknologjike,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është të krijojë një bazë për bashkëpunimin midis Zyrave në fushën e pronësisë intelektuale, në përputhje me përgjegjësitë e zyrave në këtë fushë.

Zyrat planifikojnë të bashkëpunojnë në çështje që lidhen me përfitim dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, në sistemet respektive ligjore kombëtare.

Neni 2

Fushat e Bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet Zyrave do të mbulojë kryesisht fushat e mëposhtëme:

1. shkëmbimin e informacionit mbi legjislacionin në fushën e Pronësisë Industriale (PI) dhe reflektimet për përmirësimin e tij;
2. shkëmbimin e publikimeve në fushën e PI-së;
3. bashkëpunim në fushën e përpunimit të informacionit të patentave dhe shërbimeve për publikun;
4. bashkëpunim në fushën e procesimit të informacionit të patentave dhe shërbimeve ndaj publikut;
5. organizimin e seminareve, workshop-eve dhe tryezave të rrumbullakëta rreth rolit të PI-së në inovacionin dhe rritjen ekonomike;
6. fushata për ndërgjegjësimin publik në lidhje me PI-në;
7. shkëmbimin e informacionit jo-konfidencial të lidhur me PI-në dhe praktikat më të mira;
8. bashkëpunim në ngritjen e kapaciteteve në procesin e ekzaminimit dhe grantimit të pronësisë intelektuale nga Zyrat;
9. Bashkëpunim dhe shkëmbim e praktikave të përbashkëta ndërmjet Zyrave, në lidhje me procesimet e kompjuterizuara të aplikimeve, raportet e kërkimit, proceduarat e ekzaminimit, etj;
10. trajnimin e stafit të Zyrave;
11. bashkëpunim ndërmjet nivelit të njëjtë të divizioneve të Zyrave, me qëllim të zbatimit të vendimeve dhe marrëveshjeve të menaxhuara nga Organizatat Ndërkombëtare, përkatësisht Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO) dhe Organizata Evropiane e Patentave (EPO).

Zyrat do të mundësojnë përpjekjet e tyre më të mira për të siguruar zbatimin e suksesshëm të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 3

Bashkëpunime të tjera

Bashkëpunimi i ndërmarrë si bazë e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, do të koordinohet sa më shumë me programet e tjera të bashkëpunimit që Zyrat marrin pjesë, duke përfshirë ato të organizuara nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO), Organizata Evropiane e Patentave (EPO) dhe Zyra e Bashkimit European të Pronësisë Intelektuale (EUIPO).

Neni 4

Komiteti i Monitorimit

Ngarkohet një Komitet Monitorimi i përbashkët, ku zyrtarët e secilës Zyrë do të monitorojnë dhe do të vlerësojnë zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Data, vendi dhe agjenda e Komitetit të Monitorimit, do të vendoset bashkarisht nga Zyrat.

Neni 5

Pikat e Kontaktit

Zyrat do të ngarkojnë strukturat përgjegjëse Drejtori/Sektor, si pika kontakti për të gjithë çështjet që kanë të bëjnë me këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Neni 6

Legjislacioni dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare

Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk shkakton të drejta dhe detyrime ligjore detyruese për Zyrat.

Ky Memorandum Mirëkuptimi, nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet e Palëve që rrjedhin nga çdo marrëveshje ekzistuese ose e ardhshme dypalëshe dhe shumëpalëshe, ose në të cilën çdo Palë është anëtare.

Në këtë Memorandum Mirëkuptimi, asgjë nuk do të kuptohet si palë e detyrueshme për të bërë ndryshime në ligjet dhe rregulloret aktuale ose për t'u bashkuar me ndonjë marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 7

Shpenzimet

Përjashtuar rastet kur parashikohet ndryshe, secila Zyrë do të paguajë shpenzimet e veta, që lindin nga ky bashkëpunim, veçanërisht shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e akomodimit për zyrtarët që do të qëndrojnë në zyrën ose institucionin e zyrës tjetër. Të gjithë aktivitetet e ndërmarra në këtë Memorandum Mirëkuptimi, do të jene subjekt ndaj vlefshmërisë së fondeve dhe burimeve të tjera.

Neni 8

Dispozita përfundimtare

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe do të ketë një kohëzgjatje prej pesë (5) vitesh, të ripërtëritshme për periudha shtesë me kohëzgjatje të njëjtë objekt i marrëveshjes së ndërsjelltë të Zyrave.

Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet me marrëveshje të përbashkët ndërmjet Zyrave, formalizuar në një shkëmbim dokumentesh duke specifikuar datën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve.

Secila Zyrë mund ta përfundojë këtë Memorandum Mirëkuptimi në çdo kohë, duke i bërë Zyrës tjetër njoftim me shkrim të paktën tre (3) muaj përpara datës së përfundimit të saj.

Përfundimi para kohe i këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk do të ndikojë në përmbushjen e ndonjë bashkëpunimi të pranuar sipas programeve të miratuara të punës, përveçse kur bashkarisht është rënë dakord ndryshe nga Zyrat.

Nënshkruar në Mynah, më 12.12 2019, në tre originalë, në gjuhën Angleze, Shqipe dhe Gjermanane. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, do të mbizotëroje teksti në gjuhën Angleze.

Në emër të:

Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë
Industriale të Republikës së Shqipërisë

Drejtor i Përgjithshëm

Ledina BEQIRAJ



Në emër të:

Zyrës Austriake të Patentave

President

Mariana KAREPOVA

